

**suva**



## **Sigurimi i sipërmarrësit**

Mbrojtje unike në rast aksidentesh

**Sigurimi i sipërmarrësit u ofron të vetëpunësuarve dhe anëtarëve të familjes që punojnë me ta mbrojtje unike në rast aksidentesh dhe sëmundjesh profesionale**

# Aksidentet ndodhin

## Sigurimi i sipërmarrësit ju mbron

E dinit? Shumëçka mund t'i ndodhë të vetëpunësuarve gjatë 30 viteve të punës:

- Çdo person mungon në punë më shumë se një herë për më gjatë se 30 ditë për shkak të një aksidenti.
- Një në dhjetë persona herët a vonë do të marrë pension invaliditeti.
- Një në çdo njëqind persona vdes si pasojë e një aksidenti.

Nëse të vetëpunësuarit nuk punojnë, ata nuk marrin pagë. Ata madje rrezikojnë të humbasin porositë dhe klientët nëse nuk kanë para për të paguar për një zëvendësim në rast të një mungese të zgjatur. Për fat të mirë, "Suva" ofron sigurimin e sipërmarrësit, i cili u mundëson të vetëpunësuarve të sigurohen nga aksidentet në punë dhe në kohën e lirë, si dhe nga sëmundjet profesionale. "Suva" paguan menjëherë dhe drejtpërdrejt të gjitha shpenzimet mjekësore. Përveç kësaj, viktimat e aksidentit marrin kompensim ditor ose pension. Këto pagesa në para sigurojnë të ardhurat e mëparshme ose lejojnë, për shembull, punësimin e një zëvendësi që kujdeset për gjërat në kompani.

Shembujt e mëposhtëm ilustrojnë ngjarjet në të cilat ndihmon sigurimi i sipërmarrësit:

### Shpenzime shëndetësore

Gjatë skijimit, piktori Ueli Müller plagoset dhe pëson një frakturë të komplikuar në nyjën e gjurit. Qëndrimi në spital, fizioterapia, shpenzimet mjekësore dhe rehabilitimi në klinikën e rehabilitimit të "Suva" në Bellikon paguhen drejtpërdrejt nga "Suva". Falë sigurimit të sipërmarrësit, Ueli Müller kursethet nga shpenzimet e zakonshme si tarifa e zbritshme apo ndalesa.

### Kompensimi ditor

Peter Meier kalon mbi një tra çeliku në kantierin e ndërtimit dhe bie në një gropë gërmimi. Ai nuk mund të punojë për shtatë muaj. Falë pagës së siguruar prej 70 000 frangash, ai merr çdo ditë 153,40 franga, duke përfshirë të shtunën dhe të dielën.

### Pensioni

Jacqueline Moser ka dy fëmijë dhe ka dy vjet që është e ve. Falë sigurimit të sipërmarrësit, ajo do të marrë pensionin e vejushës prej 34 000 frangash në vit për pjesën e mbetur të jetës së saj. Dhe 12 750 franga shtesë për secilin nga fëmijët e saj.

Klikoni këtu për filmin për sigurimin e sipërmarrësit



Sigurimi i sipërmarrësit shpjegohet në tre minuta. Thjesht skanoni kodin QR ngjitur me telefon inteligjent ose tablet dhe shikoni filmin. Ose zbuloni më shumë në [www.suva.ch/unternehmerversicherung](http://www.suva.ch/unternehmerversicherung).



# Siguria në punë dhe në kohën tuaj të lirë

## Shërbime gjithëpërfshirëse për sipërmarrës

Personat e vetëpunësuar ofrojnë shërbime të shkëlqyera për klientët e tyre çdo ditë. Është një gjë e mirë që sigurimi i sipërmarrësit është një partner i besueshëm që mbron sipërmarrësit në rast aksidentesh.

Sigurimi i sipërmarrësit përfshin përfitimet e mëposhtme në rast aksidenti në punë ose gjatë kohës së lirë dhe në rast të një sëmundjeje profesionale:

### Shpenzimet mjekësore dhe spitalore

- “Suva” paguan drejtpërdrejt të gjitha shpenzimet. Nuk ka shpenzime shtesë për të siguruarit: Sigurimi i sipërmarrësit nuk i njeht tarifat e zbritshme dhe ndalesat në kontribimin e shpenzimeve mjekësore.
- Hospitalizim në pavijon të përgjithshëm në të gjithë Zvicrën
- Shpenzimet mjekësore dhe spitalore mbulohen për një periudhë kohore dhe sasi të pakufizuar.

### Shërbime të pakufizuara të trajtimit dhe kujdesit

- Barnat mbulohen për një periudhë kohore dhe sasi të pakufizuar.
- Zgjedhja e lirë e mjekëve, dentistëve, kiropraktikuesve, fizioterapistëve, farmacive dhe spitaleve
- Trajtimi mjekësor jashtë vendit kryhet në shtetet e BE/EFTA dhe në disa shtete të zgjedhura në bazë të marrëveshjeve të veçanta, në pjesën tjetër të botës deri në dyfishin e shumës që do të ishte paguar nëse trajtimi do të ishte kryer në Zvicër. Për më shumë informacion, telefononi agjencinë tuaj më të afërt “Suva” në 0848 820 820.
- Janë të mbuluara trajtimet vijuese dhe spa të përshkruara nga mjeku.
- Për rehabilitimin mjekësor urgjent, “Suva” operon në klinikat e saj rehabilituese në Bellikon dhe Sion.
- Mbulohen shpenzimet shtesë për protezat, masat e shpëtimit dhe rikuperimit, si dhe për udhëtimin dhe transportin e nevojshëm për trajtim mjekësor.

## Sigurimi i të ardhurave

- Kompensim ditor i pakufizuar në kohë
- Pensioni i përjetshëm
- Pagesë e njëhershme në rast dëmtimi të përhershëm e të konsiderueshëm (kompensim për integritetin)

## Pensioni i të mbijetuarve

- Pensioni i vejushave dhe vejanëve
- Pensioni i jetimëve

## Shërbimet në rast dëmtimi

- Raportimi i aksidenteve shpejt dhe me lehtësi nëpërmjet faqes së internetit të “Suva”
- Zgjidhje e shpejtë e kërkesave
- Mbështetje personale përmes menaxhimit të rasteve për riintegrim të shpejtë në jetën e punës
- Linja e ndihmës 24-orëshe për aksidente jashtë vendit



# Të ardhura të garantuara për gjithë jetën

## Për një vështrim të relaksuar drejt së ardhmes

### Kompensim ditor

Në rast të paaftësisë afatshkurtër për punë, kompensimi ditor mbulon 80 për qind të pagës së siguruar. Në rast të paaftësisë së pjeshme për punë, kompensimi ditor reduktohet në përputhje me rrethanat.

Kompensimi ditor paguhet për çdo ditë kalendarike dhe fillon në ditën e tretë pas aksidentit. Nëse i siguruari dëshiron që pagesa të bëhet vetëm pas ditës së 15-të ose të 30-të, primi ulet deri në 40 për qind.

Kompensimi ditor paguhet derisa personi të jetë në gjendje të punojë përsëri ose derisa të fillojë pensioni i sigurimit të sipërmarrësit.

### Pensionet

Nëse pasojat e aksidentit ose sëmundjes profesionale janë aq të rënda sa i siguruari nuk mund të kryejë më


punën e tij, do të paguhet një pension i përjetshëm deri në 80 për qind të pagës së siguruar. Në lidhje me pensionin IV të invaliditetit, "Suva" do të rrisë pensionin në një maksimum prej 90 për qind.

Pensionin i invaliditetit mund të reduktohet me arritjen e moshës normale të pensionit. Reduktimi varet nga moshja në momentin e aksidentit dhe shkalla e paaftësisë. Në rast aksidenti në moshën e daljes në pension, nuk ka të drejtë për pension invaliditeti.

### Kompensimi i pafuqisë dhe integritetit

Nëse në aktivitetet e përditshme kërkohen vazhdimisht ndihma e të tretëve ose mbikëqyrja personale, pensioni i invaliditetit plotësohet me kompensimin e pafuqisë. Nëse dëmtimi fizik ose mendor është i rëndë, sigurimi i sipërmarrësit do të paguajë gjithashtu kompensim shtesë për integritetin.

## Ndërveprimi i kompensimit ditor dhe pensionit të sigurimit të sipërmarrësit



\* Periudha e pritjes: Dita e 3-të deri në të 30-të pas ndodhjes së aksidentit/sëmundjes profesionale

- 1 Nuk ka boshllëqe në sigurime: Kompensimi ditor deri në fillimin e pensioneve.
- 2 Pensioni i përjetshëm i sigurimit të sipërmarrësit.
- 3 Rritje e pensionit IV/AHV maksimalisht deri në 90% të pagës së siguruar.
- 4 Pensioni i sigurimit të sipërmarrësit rregullohet periodikisht sipas inflacionit.

Grafiku tregon përfitimet afatgjata të sigurimit të sipërmarrësit. Nëse i dëmtuari nuk është në gjendje të punojë për një periudhë më të gjatë kohore, kompensimi ditor paguhet pas një periudhe pritjeje (1). Kjo përkon me 80 për qind të pagës së siguruar.

Personi i dëmtuar përfiton kompensim ditor deri në momentin kur të jetë i aftë për të punuar përsëri. Nëse personi i dëmtuar nuk është më i aftë për punë, merret parasysh sigurimi pensional. Sigurimi i sipërmarrësit rrit pensionin e sigurimit të invaliditetit në një maksimum prej 90 për qind të pagës së siguruar. (2), (3), duke përfshirë kompensimin e inflacionit (4). Dhe kjo vetëm në "Suva", për gjithë jetën.





# Mbrojtje gjithëpërfshirëse për të gjithë familjen

## Familjarë pa shqetësime

Vejushat ose vejanët dhe fëmijët e tyre marrin pensionin e të mbijetuarit. Për disa të mbijetuar së bashku, paguhen deri në 70 për qind të pagës së siguruar.

## Pensionin i vejushave

Gratë që kanë mbushur moshën 45-vjeçare në kohën e vdekjes së bashkëshortit ose që kanë të paktën një fëmijë të tyre kanë të drejtën e pensionit dhe marrin:

- 40 për qind të pagës së siguruar,
- pagesë gjatë gjithë jetës,
- përshtatje për inflacionin.

Një e ve nën 45 vjeç pa fëmijë ka të drejtën e një kompensimi të njëhershëm.

E drejta e të vesë për pension përfundon me rimartesën.

## Pensioni për vejanët

Burrat që kanë të paktën një fëmijë në ngarkim në kohën e vdekjes së gruas së tyre kanë të drejtë për pension dhe marrin:

- 40 për qind të pagës së siguruar,
- pagesë gjatë gjithë jetës,
- përshtatje për inflacionin.

E drejta e vejanit për pension përfundon me rimartesën.

## Pensioni i jetimit

Fëmijët marrin pension deri në moshën 18 vjeç ose deri në përfundimin e shkollimit (maksimumi 25 vjeç): nëse keni humbur njërin prind, 15 për qind të pagës së siguruar, nëse keni humbur të dy prindërit, 25 për qind të pagës së siguruar.

# Sigurimi i sipërmarrësit të “Suva”

## Kush mund të sigurohet?

Të gjithë personat e vetëpunësuar dhe familjarët e tyre ose partnerët bashkëjetues që punojnë pa pagesë në kompanitë e mëposhtme mund të marrin sigurimin e sipërmarrësit “Suva”:

- Studio arkitekture
- Kompani të menaxhimit të ndërtimit
- Kompani në sektorin e ndërtimit dhe zhvillimit
- Pastrime kimike
- Dyqane instalimesh elektrike
- Ndërmarrje pyjore
- Garazhe
- Tregtia e pijeve
- Kompani të informacionit dhe inxhinierisë elektrike
- Studio inxhinierike
- Punishte mekanike
- Punishte të ortopedisë
- Dyqane radio dhe televizori
- Zdrukthëtari
- Kompani hidraulike/punimesh llamarine
- Kompani të prodhimit të konstruksioneve të çelikut dhe metalike
- Punishte të gdhendjes së gurit
- Ndërmarrje tekstili
- Kompani transporti

Lista nuk është përfundimtare.

Një konsultim falas dhe jo i detyrueshëm – sipas dëshirës edhe në vend - mund të ofrohet nga agjencia juaj më e afërt “Suva” në:

**Telefon 0848 820 820**

Informacione të mëtejshme:

[www.suva.ch/unternehmerversicherung](http://www.suva.ch/unternehmerversicherung)

# Shërbimet unike

---

## Gjithçka me një vështrim

---

### Shpenzimet mjekësore dhe spitalore

- Nuk ka tarifa zbritjeje
- Nuk ka ndalesa
- Nuk ka tavan
- Hospitalizim në të gjithë Zvicrën

---

### Kompensim ditor

- 80 % e pagës së siguruar
- nga dita e 3-të, e 15-të ose e 30-të pas aksidentit
- deri në fillimin e pensionit.

---

### Pensioni

- Maksimumi 90 % në rastin e invaliditetit total, së bashku me pensionin AHV/IV
- Shtesa për kompensimin e inflacionit

---

### Kompensimi i pafuqisë

- Shtesë për pensionin e invaliditetit, nëse vazhdimisht nevojitet ndihma e një pale të tretë

---

### Kompensimi i integritetit

- Pagesë kapitale e njëhershme shtesë deri në masën maksimale të pagës vjetore të zbatueshme në datën e aksidentit

---

### Pensioni i të mbijetuarve

- Vejushave dhe vejanët 40 %
- Jetimët që kanë humbur një prind 15 %
- Jetimët që kanë humbur të dy prindërit 25 %
- Së bashku jo më shumë se 70 %
- Së bashku me pensionin e personave të ve dhe jetimëve nga AHV 90 %
- Shtesa për kompensimin e inflacionit

---

### Përsëritjet dhe pasojat e aksidenteve të mëparshme

- Të drejta të pakufizuara raportimi

---

### Linja e ndihmës 24-orëshe për aksidente jashtë vendit

- Informacion para udhëtimit
  - Ndërmjetësimi i kujdesit mjekësor
  - Kthimi në Zvicër
-

## Modeli “Suva” Katër shtyllat



“Suva” është më shumë se një kompani sigurimesh; ajo ndërthur parandalimin, sigurimin dhe rehabilitimin.



“Suva” ia kthen fitimet të siguruarve në formën e primeve më të ulëta.



“Suva” menaxhohet nga partnerë socialë. Përbërja e balancuar e Këshillit “Suva”, e përbërë nga përfaqësues të punëdhënësve, punëmarrësve dhe qeverisë federale, mundëson zgjidhje me bazë të gjerë dhe të qëndrueshme.



“Suva” është e pavarur dhe nuk merr fonde publike.

**Suva**  
Postfach, 6002 Luzern

**Informacion**  
Tel. 058 411 12 12  
kundendienst@suva.ch

**Shkarko**  
[www.suva.ch/2727.sq](http://www.suva.ch/2727.sq)

**Titulli**  
Sigurimi i sipërmarrësit

Printuar në Zvicër  
Riprodhimi është i autorizuar,  
përveçse për përdorim tregtar,  
me kusht që të njihet burimi.  
Botimi: Mars 2022

**Numri i publikimit**  
2727.sq (në dispozicion vetëm si PDF)

